Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut

Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

VENDIM

Data e miratimit: 6 dhjetor 2012

Lënda nr. 27/09

Vladimir MANOHIN

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 6 dhjetor 2012,
me anëtarët vijues të pranishëm:

Z. Marek NOWICKI, Kryetar
Znj. Christine CHINKIN
Znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga
Z. Andrey ANTONOV, zyrtar ekzekutiv

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, të paraqitur në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas diskutimeve vendosi si në vijim:

I. PROCEDURA PRANË PANELIT

1. Ankesa u parashtrua më 27 janar 2009 dhe u regjistrua më 2 shkurt 2009.

2. Më 15 qershor 2009, 9 shkurt 2011 dhe 17 prill 2012 Paneli kërkoi nga ankuesi të paraqesë informacione plotësuese. Më 6 qershor 2012, Paneli mori informacione shtesë nga ankuesi.

3. Më 5 shtator 2012, Paneli ia komunikoi rastin Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) për komentet e UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e rastit. Më 15 tetor 2012, PSSP-ja e ofroi përgjigjen e UNMIK-ut.

II. FAKTET

Ankuesi është ish banor i Kosovës i cili aktualisht jeton në Serbi. Ai pretendon se është pronar aktual i një banese në Prishtinë. Ankuesi pohon se ai dhe bashkëshortja e tij jetuan në pronën e sipërpërmendur deri në vitin 1999 kur ata u detyruan të largohen për shkaqe sigurie. Ai thekson se e ka lejuar fqinjin e tij, z. H.F. të marrë me qira pronën e tij në bazë të një marrëveshje gojore të cilën ata e kishin bërë derisa prona u ble nga z. H.F. Mirëpo, pas disa vitesh të negociatave, kontrata e shitjes nuk u nënshkrua dhe ankuesi inicioi procedurë gjyqësor kundër z. Mr H.F pranë gjykatës komunale të Prishtinës për mospagim të qirasë dhe uzurpim të pronës. Ankuesi po ashtu parashtroi kërkesë për riposedim të pronës pranë Drejtorisë për çështje banesore pronësore (HPD) dhe pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP).

A. Procedura pranë gjykatës komunale të Prishtinës

4. Më 28 tetor 2004, ankuesi parashtroi padi pranë gjykatës komunale të Prishtinës kundër siç pohon uzurpuesit të pronës së tij, z. H.F., duke kërkuar dëbimin e tij dhe kompensimin e qirasë së papaguar.

5. Në kohën ndërmjet parashtrimit të padisë së ankuesit në vitin 2004 dhe caktimit të gjykimit të rastit nga gjykata komunale në vitin 2006, një person tjetër, z. A.K. e kishte okupuar pronën. Ankuesi e ndryshoi ankesën për të përfshirë z. A.K.

6. Më 5 prill 2006, gjykata komunale e Prishtinës caktoi një seancë për rastin e ankuesit. Mirëpo, ankuesi si duket nuk e ka marrë njoftimin deri pas caktimit të seancës dëgjimore dhe kështu ai nuk u paraqit në gjykatë.

7. Më 14 shtator 2006, gjykata komunale e Prishtinës mbajti një seancë tjetër dëgjimore. Në këtë seancë nuk u paraqit as paditësi as të padituri, edhe pse përfaqësuesi ligjor i paditësit – i cili ishte i pranishëm- ishte urdhëruar nga gjykata që t'i sigurojë adresat e sakta të dy të padituve brenda tridhjetë ditësh. Në tetor të vitit 2006, ankuesi ishte njoftuar se ishte ndërprerë përfaqësimi ligjor që ai e kishte marrë nga organizata joqeveritare PRAXIS, dhe që kishte marrë pjesë në seancën e mëparshme dëgjimore.

8. Më 13 prill 2007, gjykata komunale e Prishtinës nxori një aktgjykim me të cilin e hodhi poshtë kërkesën pronësore të ankuesit si të pakompletuar, meqë gjykatës nuk i kishte siguruar adresën e saktë të të padituve ashtu siç ishte urdhëruar më 14 shtator 2006. Ankuesi thekson se ai nuk ka marrë as kopje të urdhrit të sipërpërmendur as aktgjykimin e gjykatës komunale të Prishtinës të datës 13 prill 2007.

9. Më 9 dhjetor 2008, përgjegjësia e UNMIK-ut lidhur me gjyqësorin në Kosovë përfundoi me marrjen e kontrollit të plotë operacional nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në fushën e sundimit të ligjit, pas deklaratës së bërë nga Kryetari i Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara më 26 nëntor 2008 (S/PRST/2008/44), duke përshëndetur angazhimin e vazhdueshëm të Bashkimit Evropian në Kosovë.

10. Më 26 prill 2012, ushtruesi i detyrës së kryetarit të gjykatës komunale të Prishtinës i dërgoi Panelit një letër me të cilën pranoi se ajo nuk ka gjetur dëshmi se aktgjykimi i kësaj gjykate i datës 13 prill 2007 ju kishte dërguar ankuesit apo përfaqësuesit të tij ligjor. Ajo

po ashtu shprehu keqardhje për ankuesin dhe tha se ai kishte në dispozicion mjete të tjera ligjore.

11. Më 12 qershor 2012, Paneli e informoi gjykatën komunale të Prishtinës se ankuesi asnjëherë nuk e kishte marrë aktgjykimin e saj të datës 13 prill 2007.

B. Procedura pranë Drejtorisë për çështje banesore pronësore dhe Agjencisë Kosovare të Pronës

12. Më 6 mars 2004, ankuesi parashtroi kërkesë pranë HPD për riposedim të pronës në Prishtinë. Mirëpo, kërkesa nuk u pranua nga HPD meqë ishte parashtruar pas afatit kohor.

13. Më 6 mars 2007, ankuesi parashtroi një kërkesë të ngjashme pranë AKP (AKP 28259) për riposedim të pronës së njëjtë. Më 20 korrik 2011 dhe qershor 2012, AKP e informoi Panelin se kërkesa e ankuesit ishte akoma duke u proceduar për shkak të nevojës së shkëmbimit të dokumentacionit mbështetës në mes të palëve. Kjo kërkesë me sa duket është akoma në proces të trajtimit.

III. ANKESA

14. Ankuesi në esencë pohon se gjykata komunale e Prishtinës e ndaloi procedimin e ankesës së tij private për uzurpim pa e njoftuar atë në mënyrë efektive dhe të duhur. Prandaj, e drejta e tij për gjykim të drejtë, e garantuar me nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) ishte shkelur për shkak se gjykata komunale e Prishtinës nuk e kishte njoftuar atë për procedurën që ishte pranë kësaj gjykate. Ai po ashtu ankohet se dështimi i gjykatës komunale të Prishtinës për ta informuar atë për aktgjykimin e saj e shkeli të drejtën e tij për të marrë vendim brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

15. Ankuesi po ashtu ankohet edhe për kohëzgjatjen e procedurës pranë AKP-së lidhur me kërkesën e tij pronësore. Në këtë aspekt mund të konsiderohet se ai thirret në shkeljen e të drejtës së tij për të marrë vendim nga një gjykatë brenda një kohe të arsyeshme, në kuptim të nenit 6 § 1 të KEDNJ dhe në të drejtën e tij për pronë, të garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.

IV. LIGJI

16. Para se të shqyrtohet rasti për bazueshmërinë e tij Paneli duhet të vendosë nëse do ta pranojë rastin, duke marrë parasysh kriteret për pranim të përcaktuara në nenet 1, 2 dhe 3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12 të datës 23 mars 2006 për themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut.

A. A janë shterur të gjitha mjetet në dispozicion?

17. PSSP-ja nuk e kundërshton pranueshmërinë e ankesës, për mos-shterim të mjeteve në dispozicion. PSSP-ja, duke cituar letrën e ushtruesit të detyrës së kryetarit të gjykatës komunale të Prishtinës, thekson se "mjete të tjera juridike janë në dispozicion për [ankuesin]", dhe prandaj ankesa e ankuesi drejtuar Panelit është e parakohshme (shih § 11 lart). Gjithashtu, PSSP-ja argumenton se procedurat pranë AKP-së janë akoma duke vazhduar dhe prandaj kjo çështje akoma nuk është përfunduar, për shkak se përderisa këto kërkesa janë akoma duke iu nënshtruar këtyre proceseve, nuk mund të thuhet se ankuesi ka shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion.

18. Paneli konsideron se sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, ankuesi duhet të ketë mbështetjen e zakonshme për mjetet që janë në dispozicion dhe janë efikase për të dhënë kompensim lidhur me shkeljet e pohuara. Ekzistimi i mjeteve në fjalë duhet të jetë mjaftueshëm i sigurt jo vetëm në teori por edhe në praktikë, dështimi i të cilave sjell tek mungesa e qasjes dhe efektivitetit të nevojshëm (HRAP, *Balaj dhe të Tjerët*, nr. 04/07, vendim i 31 marsit 2010, § 45; HRAP, *N.M. dhe të Tjerët*, nr. 26/08, vendim i 31 marsit 2010, § 35; krahaso, lidhur me kushtin për shterimin e mjeteve vendore sipas nenit 35 § 1 të KEDNJ, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) (Grand Chamber), *Paksas kundër Lituanisë*, nr. 34932/04, aktgjykim i 6 janarit 2011, § 75). Paneli zakonisht duhet të jetë ai i cili është i kënaqur se procesi gjyqësor, sikurse çdo mjet tjetër që mund të jetë shtuar nga UNMIK-u, "ka qenë efektiv, i disponueshëm në teori dhe në praktikë në kohën përkatëse, d.m.th. se ka qenë i qasshëm, ka qenë mjet që ka qenë në gjendje të sigurojë kompensim lidhur me ankesën e ankuesit dhe ka ofruar perspektivë të arsyeshme për sukses" (shih HRAP, *Balaj dhe të tjerët*, § 45, dhe *N.M. dhe të Tjerët*, § 35, sa i përket GJEDNJ, *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë*, aktgjykim i 16 shtatorit 1996, *Raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve*, 1996-IV, f. 1211, § 68).

19. PSSP-ja, duke cituar letrën e ushtruesit të detyrës së kryetarit të gjykatës komunale të Prishtinës, në esencë ka theksuar se ankuesi mund të paraqesë edhe padi të tjera pranë gjykatës komunale në Prishtinë lidhur me ankesat e tij private kundër uzurpuesve të pretenduar. Sa i përket Panelit ai pajtohet me PSSP-në lidhur me paditë private të ankuesit; duket se akoma ekziston mundësia për ankuesin të paraqesë ankesë kundër aktgjykimit të gjykatës komunale të Prishtinës, datë 13 prill 2007.

20. Prandaj, Paneli konsideron se me paraqitjen e një ankese të tillë, ankesa e ankuesit për uzurpimin do të mund të dëgjohej pranë një organi kompetent gjyqësor në një proces efektiv dhe të drejtë, duke korrigjuar në këtë mënyrë çfarëdo të metash që mund të jenë paraqitur më parë.

21. Kështu që, Paneli gjen se ankesa e ankuesit lidhur me të drejtën e tij për gjykim të drejtë është e papranueshme për shkak të mosshterimt të mjeteve në dispozicion, ashtu siç kërkohet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

22. Sa i përket vërejtjes së PSSP-së për mosshterimin e kërkesës së ankuesit pranë AKP-së dhe ankesës së ankuesit kundër gjykatës komunale të Prishtinës për vonesën e paarsyeshme në dhënien e aktgjykimit të saj, Paneli thekson se këto ankesa kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e procedurës. Ankesat e tilla mund të parashtrohen pranë tij, edhe para përfundimit të procedurës në fjalë (shih, lidhur me aplikacionet drejtuar Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), *p.sh*., GJEDNJ, *Biçer kundër Turqisë*, nr. 19441/04, aktgjykim i 20 korrikut 2010, § 20). Paneli në të vërtetë nuk sheh se si fakti se procedura është akoma në pritje mund të korrigjojë shkeljen e pohuar të nenit 6 § 1 të

KEDNJ që buron nga kohëzgjatja e procedurës (shih GJEDNJ, *Todorov kundër Bullgarisë*, nr. 39832/98, vendim i 6 nëntorit 2003).

23. Prandaj, Paneli konkludon se këto ankesa nuk mund të refuzohen për mosshterimin e mjeteve në dispozicion në kuptim të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12. Paneli e hedh poshtë këtë vërejtje të PSSP-së.

B. Vonesa në dërgimin e aktgjykimit të gjykatës komunale të Prishtinës

24. Ankuesi ankohet se gjykata komunale e Prishtinës asnjëherë nuk ia ka dërguar vendimin e saj të datës 13 prill 2007, me të cilin u hodh poshtë ankesa e tij për uzurpim për shkaqe procedurale. Në këtë aspekt, ai në esencë ankohet se gjykata komunale e Prishtinës e shkeli të drejtën e tij për marrjen e një vendimi brenda një kohe të arsyeshme, të garantuar me nenin 6 § 1 të KEDNJ.

25. Paneli thekson se më 26 prill 2012, ushtruesi i detyrës së kryetarit të gjykatës komunale të Prishtinës i dërgoi Panelit një letër duke shprehur keqardhje për trajtimin e rastit të ankuesit dhe duke theksuar se ajo nuk ka gjetur dëshmi se aktgjykimi i kësaj gjykate i datës 13 prill 2007 ju ka dërguar ndonjëherë ankuesit apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ligjor. Për më tepër, ankuesi nuk e kishte marrë aktgjykimin deri në vitin 2012.

26. Nga kohëzgjatja e përgjithshme prej më shumë se pesë vite dhe dy muaj, periudha ndërmjet prillit 2007 dhe dhjetorit 2008 paraqet përafërsisht një vit e tetë muaj që është në kuadër të juridiksionit të Panelit për shqyrtim.

27. Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës ngrit çështje serioze faktike dhe juridike, vendosja e të cilave do të duhej të varet nga shqyrtimi i bazueshmërisë. Prandaj, Paneli konkludon se kjo pjesë e ankesës nuk është e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

28. Arsye tjetër për shpalljen e kësaj pjese të ankesës të papranueshme nuk është konstatuar.

29. Sa i përket periudhës pas 9 dhjetorit 2008, kjo pjesë e ankesës është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit (shih § 10 lart).

C. Procedura pranë Agjencisë Kosovare të Pronës

30. Ankuesi po ashtu ankohet se AKP-ja ia ka mohuar marrjen e vendimit brenda një periudhe kohore të arsyeshme, dhe se ja ka vonuar njohjen e të drejtave pronësore. Ankuesi e ka parashtruar kërkesën e tij pranë AKP-së më 6 mars 2007 dhe akoma është në pritje për të marrë vendim, më shumë se pesë vite dhe nëntë muaj më vonë.

31. Paneli thekson se sa i përket kontrollit administrativ të UNMIK-ut mbi AKP-në, Sekretari i Përgjithshëm i KB-së në raportin e tij drejtuar Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Misionin e Administratës së Përkohshme në Kosovë, të datës 17 mars 2009, thekson se meqë autoriteti i UNMIK-ut mbi AKP-në nuk u vazhdua pas 31 dhjetorit 2008, autoritetet e Kosovës dhe një drejtor ndërkombëtar, i emëruar nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar/Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian ka marrë kontrollin e plotë operacional mbi AKP-në. Pas kësaj, AKP-ja ka vepruar në pajtim me legjislacionin e miratuar nga Kuvendi i Kosovës (S/2009/149, § 24; shih Paneli Këshillëdhënës për të

Drejtat e Njeriut (HRAP), *Kushiç*, nr. 08/07, mendim i 15 majit 2010, § 51; HRAP, *Felegi*, nr. 32/08, vendim i 20 janarit 2012, § 43).

32. Kështu që, ashtu siç ka vendosur Paneli tanimë në *Kushiç* (cituar në § 32 lart, në § 52) dhe në *Felegi* (cituar në § 32 lart, në § 44), se nga 31 dhjetori 2008, UNMIK-u nuk mund të mbahet përgjegjës për veprimet apo mosveprimet me të cilat ngarkohet AKP-ja.

33. Nga kohëzgjatja e përgjithshme e procesit të AKP-së prej më shumë se pesë vite e njëmbëdhjetë muaj, periudha ndërmjet marsit 2007 dhe dhjetorit 2008 paraqet përafërsisht një vit dhe nëntë muaj që janë në juridiksionin e Panelit për shqyrtim.

34. Duke marrë parasysh numrin e madh të kërkesave të parashtruara pranë AKP-së (42,239 kërkesa, nga të cilat 34,309 janë vendosur deri më 6 dhjetor 2012)[1], Paneli nuk konsideron se gjatë periudhës në kuadër të juridiksionit të Panelit ka pasur vonesë të kohëzgjatjes së tillë e cila ka qenë e paarsyeshme. Prandaj, sa i përket periudhës në fjalë Paneli konsideron se kjo pjesë e ankesës është e pabazuar në shikim të parë në kuptim të nenit 3.3 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12.

35. Sa i përket periudhës pas 31 dhjetorit 2008, ankesa është jashtë juridiksionit *ratione personae* të Panelit (shih § 32 lart).

PËR KËTO ARSYE,

Paneli unanimisht,

– E SHPALL ANKESËN TË PRANUESHME LIDHUR ME VONESËN E DËRGIMIT TË AKTGJYKIMIT TË GJYKATËS KOMUNALE TË PRISHTINËS (NENI 6 § 1 i KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT);

– E SHPALL TË PAPRANUESHME PJESËN TJETËR TË ANKESËS.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryetar

[1] Qasja në informacione më 6 dhjetor 2012 nga uebsajti zyrtar i AKP-së: http://www.kpaonline.org/ClaimsTotalDecided_caseload.asp